



**TË DUROSH SI ZEJNEBJA,
E BIJA E IMAM ALIUT**

(Paqja qoftë mbi ta!)

Tiranë, 2024

Titulli i librit:

**Të durosh si Zejnebja, e bija e Imam
Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*)**

Përzgjedhi dhe përktheu:

Sabrie FEZA

Redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrekttoi: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja kompjuterike & kopertina:

Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata “Flladi”



Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Hazreti Zejneb Kubra (*Paqja qoftë mbi të!*) lindi më 5 Xhemadi Ula të vitit 5 ose 6 Hixhri Kameri, në qytetin e Medines. Babai i saj, është i nderuari, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nëna e saj, është e nderuara, Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo është mbesa e vulës së Profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut*



qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), është motra e prijesve të Xhenetit, Imam Hasanit dhe Imam Hysenit (Paqja qoftë mbi ta!).

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*), për ne, është bërë e njohur më shumë që nga ndodhia e Qerbelasë. Roli i saj në ngjarjen e Ashures dhe deri në të dyzetat ishte shumë i rëndësishëm. Ajo, në ngjarjen e Qerbelasë, kishte rol kyç jo vetëm për vazhdimin e lëvizjes, por edhe për rritjen e zjarrit të kryengritjes së Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Në këtë artikull, do të përpiqemi të nxjerrim në pah disa nga karakteristikat më të rëndësishme të Hazreti Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*). Një ndër to është



durimi. Do të qëndrojmë në këtë tipar të Hazreti Zejnebes, me qëllim që ndoshta gjejmë një mënyrë për të arritur një durim kaq të bukur, sikurse e kishte ajo.

Durimi përballë problemeve dhe fatkeqësive është urdhëruar në shumë ajete dhe hadithe. Sa herë që bëhet fjalë për durimin, menjëherë në mendje na vjen Profeti Ejub (*Paqja qoftë mbi të!*), i duruar përballë sëmundjes, si dhe Hazreti Zejnebja, e bija e Fatime Zehrasë dhe e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*), e duruar ndaj fatkeqësive që i ndodhën në Qerbela, sepse ajo e ka parë me sytë e saj ngjarjen më të dhimbshme, më të rëndë dhe më të vështirë të historisë, ka pasur peshën e rëndë të martirizimit të shtatëdhjetë e dy



familjarëve e të afërmve, përveçse ka qenë në krye të karvanit të robërve nga Qerbelaja për në Sham. Përkundër gjithë kësaj, kur ajo ishte në pallatin e Jezidit, iu përgjigj, pa iu trembur syri pyetjes së tij: “A e pe se çfarë bëri Zoti yt me ju në Qerbela?” Ajo u përgjigj: «ما رأيتُ إلا جميلاً» - “Nuk pashë gjë tjetër veç bukurisë”.¹ Për këtë arsye, ajo konsiderohet unike për durimin, forcën e besimit dhe devotshmërinë.

Kudo që përmendet emri i Zejnebes, së bashku me të, vjen edhe fjala durim. Durimi dhe qëndresa e saj përballë të gjitha vuajtjeve të jetës që hoqi në Medine dhe Qerbela, e më pas, nga Qerbelaja në Kufe e

¹ “Tenkihul Mekal fil ilm el-Rijal”, Abdullah bin Muhammed Hasan Mamekani, vëll. 79.



nga Kufja në Sham (Siri). Të gjitha këto nuk janë të fshehta për askënd. Ky durim buron nga meditimi dhe qëndrimi i saj i bukur, kur thotë: “Nuk pashë gjë tjetër veç bukurisë”.

Një nga karakteristikat e durimit të Zejnebes është bukuria e durimit të saj. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka thënë: “*Durimi i bukur është durimi në të cilin nuk ka ankim*”.²

Durimi i bukur është si durimi i profetëve dhe të dashurve të Allahut kundër persekutimit e torturave të kundërshtarëve, politeistëve dhe armiqve.

² Tefsiri “El Kurtubi”, vëll 5, f. 338.



Një person që karakterizohet nga ky tipar i bukur, nuk e akuzon Zotin për padrejtësi në kohë fatkeqësie, por jeton, duke besuar se çdo gjë që ndodh nga Zoti, e ka një të mirë.

Allahu i Madhëruar, në ajetin 24 të sures “Er Ra’d” thotë: “(...e do t’u thonë): **‘Paqja qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar (në jetën e kësaj bote)!’**”.

Fjala durim është përsëritur 103 herë në Kur’an. Në shumë raste, përdorimi i saj është i përgjithshëm, nuk jepet ndonjë shembull i veçantë për të dhe do të thotë këmbëngulje dhe durim absolut i çdo lloji. Në disa ajete të tjera i referohet një durimi të veçantë. Disa nga këto ajete flasin për



durimin e profetëve (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) dhe të devotshmëve të Allahut të Madhëruar. Në ajetet 45-46 të sures “El Bekare” thuhet: **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit, që janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se do të kthehen tek Ai”**.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i numëroi shenjat e njeriut të durueshëm dhe tha: *“Durimtari nuk mërzitet dhe lodhet, nuk shqetësohet dhe nuk ankohet për Zotin e tij”*.³

³ “Biharul Enuar”, vëll. 71, 86.



Për shkak të kësaj, kur Zejnebe Kubra (*Paqja qoftë mbi të!*) u dërgua në pallatin e Jezidit, si robëreshë, pas ndodhisë së Qerbelasë, kur Jezidi i tha: “A e pa se çfarë të bëri Zoti dhe çfarë ju ndodhi në Qerbela?”, ajo iu përgjigj: «ما رأيتُ إلا جميلاً» - “Nuk pashë gjë tjetër veç bukurisë”. Kjo fjali tregon pozitën e lartë të durimit dhe të qetësisë së kësaj zonje të madhe, që iu dorëzua urdhrit dhe gjykimit të Allahut. Ky lloj durimi i kësaj zonje të madhe është zbatimi i ajetit: **“Prandaj, duro, me durim të bukur”**.⁴

Durimi përballë problemeve dhe fatkeqësive kërkon një vetëdije, njohuri

⁴ Sure “El Mearixh”, ajeti 5.



dhe besim të madh. Nëse një person e di se çfarë e vërtete dhe mençurie fshihet pas asaj që i ndodh, atëherë ai mund të jetë i durueshëm përballë vështirësive.

Sipas ajeteve kur'anore, vetëdija dhe njohja e filozofisë së ngjarjeve që kanë ndodhur, është themeli i durimit. Në këtë mënyrë, për aq kohë sa njeriu të mos jetë i vetëdijshëm për problemet dhe fatkeqësitë, ai e trajton problemin me zemërim dhe mllef, madje ndonjëherë mund të bëjë kufër (të mohojë Zotin).

Allahu i Madhëruar na njofton në shumë ajete, në Kur'an, për fatin e paraardhësve tanë, duke treguar një nga faktorët e durimit përballë



kundërshtimeve dhe armiqësive, në mënyrë që Profeti i Zotit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët të jenë të durueshëm përballë veprimeve dhe ngjarjeve që hasin gjatë rrugës së jetës. **“Unë i kam shpërblyer ata sot për durimin e tyre e ata, me të vërtetë, janë të shpëtuar”.**⁵

Një nga fjalitë e rëndësishme dhe kyçe të Hazreti Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*), në ngjarjen e Ashures, e cila tregon durimin, së bashku me diturinë e kësaj zonje fisnike, ishte: « الحمد لله الذي أكرمنا بالشهادة » - “Elhamdulil’lahil’ledhi ekramna bish shehadeh” - “Falënderimi i takon Allahut, i

⁵ Sure “Mu’minun”, ajeti 111.



Cili na nderoi ne me martirizim". Allahu thotë: **"Njerëz të tillë do të shpërblehen me Xhenet të lartë për durimin e tyre dhe do të mirëpriten e do të gjejnë paqe. Aty do të qëndrojnë përherë; sa vendbanim dhe vendstrehim i mrekullueshëm që është ai!"**⁶

I duruar është ai njeri që nuk pikëllohet përballë vuajtjeve dhe nuk e kundërshton Allahun. Durimi i Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*), i kësaj zonje të nderuar, është i mahnitshëm. Ajo është falënderuese për fatkeqësinë, sepse nuk e shikon si fatkeqësi, por si dhuratë. Për këtë arsye, ajo është e kënaqur me kënaqësinë e Allahut. Ajo e ka kuptuar madhësitinë e Allahut

⁶ Sure "El Furkan", ajetet 75-76.



dhe, për këtë arsye, fatkeqësitë duken të vogla në sy të saj.

Allahu, në Kur'an, i ka përgëzuar durimtarët dhe u ka dërguar përshëndetjet e Tij: **"...Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: 'Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!' Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në Rrugën e Drejtë!"**⁷

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në komentimin e këtij ajeti, ka thënë: "Thënia jonë: **"Të Allahut jemi"** është dëshmi, se ne nuk jemi të pavarur, jemi pronë e Alahut. Thënia jonë:

⁷ Sure "El Bekare", ajetet 155-157.



“dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” është dëshmi, se jemi të paqëndrueshëm”.⁸

Në ajetin 46 të sures “En Enfal”, Allahu u premton shoqëri durimtarëve: **“Dhe bëni durim, se Allahu është me durimtarët”.**

Në një vend tjetër të Kur'anit, në përshkrimin e shpërblimit të durimtarëve, Allahu thotë: **“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në pallatet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj; aty do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa i bukur është shpërblimi i atyre që**

⁸ “Nehxhul Belaga”, Thënie të shkurtra, Thënia 99.



punojnë mirë, të cilët kanë duruar dhe janë mbështetur te Zoti i tyre”.⁹

Në një hadith, i përcjellë prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), lexojmë se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur të shpërndahet libri i punëve dhe, kur të vendosen peshoret, për të sprovuarit as nuk do të vihet peshore e as nuk do t’u jepet libri i punëve” dhe pastaj lexoi ajetin: “...**pa dyshim, që të durueshmëve u jepet shpërblimi pa masë**”.¹⁰

Durimi është aq i rëndësishëm për besimin, saqë në hadithe paraqitet si kreu i

⁹ Sure “El Ankebut”, ajetet 58-59.

¹⁰ “Biharul Enuar”, vëll. 67, f. 101.



besimit. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në një transmetim, thotë: *“Raporti i durimit me besimin është si raporti i kokës me trupin. Nëse humbet koka, humbet edhe trupi, nëse humbet durimi, humbet edhe besimi”*.¹¹

Besimtarit, të cilit i është rrënjosur besimi në zemrën e tij, është si një mal i fortë, nuk do ta tundin erërat dhe sado fatkeqësi dhe sprova të pësojë, besimi i tij nuk do t’i priset aspak, por për shkak të durimit, kënaqësisë dhe mbështetjes në Allah, forca e besimit të tij do të rritet. Shenja dhe cilësia e besimtarëve, besimi i të cilëve ka depërtuar në zemrat e tyre, është se ata e dinë dhe janë të sigurt, se të gjitha

¹¹ “El Kafi”, vëll 2, f. 87.



punët kryhen me fuqinë e Allahut dhe çdo gjë kryhet në kohën e vet, bazuar në diturinë dhe urtësinë e përjetshme.

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) kërkoi ndihmë nga Zoti, në të gjitha gjendjet dhe pa vetëm të vërtetën. Në lutjen që ka bërë në natën e 11-të të ngjarjes së ditës së Ashures, shihet mbështetja dhe kapja pas Zotit në jetën e kësaj zonje fisnike, e cila thotë: “Ja Imade Men La Imade Leh. Ya Senede Men La Senede Leh.”-“O Kolonë për atë që nuk gjen kolonë! O Mbështetës i atij që nuk ka mbështetës!”

Hazreti Zejnebja është shembull për të gjithë. Duron dhe është e kënaqur me



caktimin e Allahut, edhe pse shpirti e kraharori i digjeshin nga pikëllimi i humbjes së të dashurve të saj. Nëse Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk do të kishte duruar, nuk do të mbetej gjurmë e Islamit. Fjalimet dhe qëndresa e saj, bëri që Jezidi, kalifi i asokohe dhe shokët e tij, jo vetëm u turpëruan, por u doli sheshit fytyra e vërtetë. Sot, edhe pse kanë kaluar shekuj nga ngjarja e Qerbelasë, mbijetesa e Islamit i detyrohet guximit dhe këmbënguljes së Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*). “Qerbelaja do të mbetej në Qerbela, nëse nuk do të ishte Zejnebja...”. Zonja e madhe Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) është shembull i lartë në histori. Kjo tregon rolin e madh të femrës në çështjet madhore të Islamit. Thuhet se në Qerbela, gjaku triumfoi ndaj



shpatës. Vërtet, ai triumfoi. Faktori kryesor i këtij triumfi ishte zonja e madhe Zejneb, e bija e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ushtria e Jezidit, gjatë largimit nga Qerbelaja, familjen e robëruar të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pjesëtarët e tjerë të karvanit, i dërguan pranë vendit ku ishin martirët, në mënyrë që familja e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*) të digjej shpirtërisht akoma më shumë nga kjo tragjedi. Imam Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) luftonte për dinjitet në këtë botë dhe në Botën Tjetër, prandaj ushtria e Jezidit mudohej ta paraqiste Imam Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*) të dobët para dhe pas martirizimit. Për këtë arsye, ata dërguan gratë dhe fëmijët pranë trupave të vrarë



dhe të masakruar të të dashurve të tyre. Kur Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) arrin pranë trupit të masakruar të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), vëren se trupi i tij jo vetëm që nuk kishte kokë, por çdo gjë në trupin e tij ishte e copëtuar nga shpata. Ajo u përkul ngadalë. Largoi gurët dhe shtizat e thyera. Vendosi dy duart nën trupin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), e ngriti atë dhe tha: “O Zot! Pranoje prej nesh këtë kurban!” Kjo është fjala e një gruaje, që të gjithë e dinë se Hyseni (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte gjithçka që ajo kishte. Mirëpo, ajo, me këto fjalë, deklaroi për të gjithë: “Ne Hysenin e kemi sakrifikuar në rrugën e Allahut dhe të fesë. E lusim Allahun që ta paranojë këtë kurban prej nesh!”



E lusim Allahun që të na bëjë prej atyre që durojnë me durim të bukur, ashtu sikurse duroi edhe zonja e madhe Zejneb, përballë gjithë fatkeqësive.

Fjalimi i Hazreti Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*) në pallatin e Jezidit

Ibn Ebu Tejfur Bagdadi, në një transmetim, ka thënë: “Kur Jezidi filloi të godasë me një shkop bambuje dhëmbët e bekuar të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërsa ai po recitonte poezi, Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) u ngrit e lexoi thënien e Allahut: **“Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe**



(Xhehenemi), **ngase i mohonin Shpalljet e Allahut dhe talleshin me to**".¹²

O Jezid! Ti mendon se tani që toka dhe qielli na janë ngushtuar, e po na çojnë si robër sa në një anë në tjetrën, është sepse Zoti na ka poshtëruar ne dhe të ka nderuar ty, për shkak të statusit tënd të lartë në sytë e Zotit?! Prandaj je kryelartë dhe shikon përreth me krenari, je i lumtur dhe i dehur, kur sheh se bota është sipas dëshirës tënde dhe gjërat shkojnë sipas dëshirës tënde?! Vërtet, ju është dhënë afat dhe jeni lënë të lirë. Kjo është fjala e Allahut të Madhëruar dhe të Lartësuar: **"Le të mos mendojnë kurrsesi jobesimtarët se për ata është mirë**

¹² Sure "Er Rum", ajeti 10.



që ua zgjasim jetën. Ne ua zgjasim jetën vetëm për t'u shtuar gjynahet; për ata ka ndëshkim poshtërues".¹³

O bir i të liruarve (të divorcuarve)! A është drejtësi kjo që ti i vendos gratë dhe shërbëtoret e tua pas perdes (të mbrojtura nga shikimet), ndërsa vajzat e Profetit të Allahut i zë robër, ua heq velin e shenjtërisë së tyre dhe lejon që klithma e zërit të tyre të dëgjohet nga burrat e huaj? Ato, të hipura mbi deve, ndërsa armiqtë e tyre u vijnë rrotull, duke i dërguar sa në një qytet në tjetrin. Askush nuk kujdeset për to dhe nuk kanë strehë, kanë ardhur t'i vëzhgojnë të largët e të afërt, e asnjë kujdestar i tyre

¹³ Sure "Ali Imran", ajeti 178.



nuk i shoqëron. Si mund të presim që një person që na shikon me hasmëri, urrejtje, zili dhe keqdashje, të sillet mirë me ne?! Ju thoni: “Ah, sa do të doja të më shihnin sot paraardhësit e mi, të cilët u vranë në betejën e Bedrit!” Pa e konsideruar këtë krim si të madh dhe pa u ndier fajtor, godisni edhe dhëmbët e Aba Abdilahut (Imam Hysenit) me shkopin tuaj!

Si mund të mos thuash se ke derdhur gjakun e djalit të Profetit të Allahut dhe të yjeve të tokës nga familja e Abdul Mutalibit?! Na keni hedhur kripë në plagë, duke na lënduar. Shumë shpejt do të dilni para Zotit dhe do të dëshironit të ishit të verbër dhe të shurdhër dhe nuk do të kishit thënë kurrë “paraardhësit e mi



gëzoheshin për këtë që bëra dhe këndonin të gëzuar!” O Zot, merre hakun tonë dhe hakmerru ndaj atyre që na kanë bërë padrejtësi! Pasha Zotin, ti me këtë krim vetëm ke rrjepur lëkurën tënde dhe mishin tënd e ke prerë copa-copa. Në Ditën e Kiametit do të detyrohesh të qëndrosh e do të paraqitesh para të Dërguarit të Allahut. Në po atë ditë, Zoti e tubon familjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndërsa shpirti i Imam Hysenit është pranë tij, në pozitat më të larta. Ky është kuptimi i ajetit të nderuar: **“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në Rrugën e**



Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre”.¹⁴

Atje do ta dijë fundin e punës ai që të ndihmoi të arrish në qeveri dhe ju hapi rrugën! Aty ku Zoti është Gjykatësi dhe Muhamedi është paditësi, pjesët e trupit tuaj do të jenë dëshmitarë. Sa vend i keq që është për të ligët! Aty do ta dini se cili prej jush është më i keqi, në aspektin e vendndodhjes dhe më i dobëti në ushtarë.

O armik i Zotit dhe bir i armikut të Tij! Betohem në Allah, nëse presioni i kohës më ka detyruar mua të flas me një njeri si ti, dije se pozita jote nuk ka vlerë për mua, të konsideroj të ulët dhe të pavlerë, mirëpo

¹⁴Sure “Ali Imran”, ajeti 169.



gjej rastin të të qortoj dhe të të fajësoj për gjithçka ke bërë për ne. Por çfarë të bëj, kur më qajnë sytë dhe më digjet shpirti?! Pas martirizimit të Hysenit, kjo nuk është më e dobishme dhe nuk do të më qetësojë. Pasuria e Zotit ju jepet për të shkelur tabutë hyjnore, kështu që ju mund të shihni se gjaku ynë rrjedh nga këto duar dhe mishi i trupit tonë është nën dhëmbët e këtij populli dhe ata trupa të pastër po shqyhen nga ujqërit e shkretëtirës! Tani, nëse na merr si plaçkë (robër), sigurohu se do të jesh borxhli atë Ditë, kur nuk do të gjesësh asgjë përveç veprave të tua! Në atë kohë, ti dhe i biri i Merxhanes, do t'i thërrisni njëri-tjetrit dhe do t'i kërkonin ndihmë njëri-tjetrit. Ti dhe shokët e tu do të dridheni para peshores së drejtësisë hyjnore, kur të



shihni se barra më e mirë që ju la Muavija, ishte vrasja e pasardhësve të Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Betohem në Allah, se ti nuk e ndoqe rrugën e Zotit dhe unë nuk lavdëroj tjetër përveç Tij. Pra, planifiko, përpiku dhe vendose mendjen në punë (për të fshirë turpin e këtij krimi). Por, betohem në Allah, se nuk do të mund ta largoni kurrë turpin e këtij krimi, që keni bërë ndaj nesh!

Falënderimi i takon Allahut, i Cili u solli lumturi dhe falje prijësve të rinjve të Xhenetit (Imam Hasanit dhe Imam Hysenit) dhe u dhuroi Xhenetin. E lus Allahun që t'ua lartësojë gradën dhe t'u japë bekimin e Tij të pafund, sepse Ai është Mbrojtësi dhe Fuqiploti".



Jezidi kishte heshtur, derisa Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) mbaroi së foluri, pastaj Jezidi recitoi këtë poezi:

"Mes klithmave,

një klithmë është e denjë për lavdërim!

Sa e lehtë është të vajtosh

për ata që vajtojnë!"

Pas kësaj, Jezidi urdhëroi që gratë të vendoseshin së bashku me Ali bin Hysenin, Imam Sexhadin (*Paqja qoftë mbi ta!*) në një shtëpi, pranë shtëpisë së tij. Pasi shtëpia u bë gati, me të gjitha gjërat e nevojshme, robërit i çuan atje. Gratë e



familjes së Muavijes u mblodhën dhe i pritën me lot, duke vajtuar për Hysenin (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo situatë vazhdoi për tri ditë.

Damasku, qendra e pushtetit të Jezidit, gjithashtu, trazohet me fjalët e guximshme të Hazreti Zejnebes. Një qytet, që deri dje ishte veshur ngjyra-ngjyra, përnjëherë vishet i tëri me të zeza. Pushtetarët e dinastisë emevite, që deri dje ishin të entuziazmuar nga fitorja në luftën e Qerbelasë, tani ishin robëruar nga Hazreti Zejnebe dhe Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*). Zejnebja nuk kishte frikë nga armiqtë e armatosur deri në dhëmbë, por u bërtiste atyre me zë të lartë dhe i poshtëronte ata. Jezidi u poshtërua aq



shumë përpara saj, saqë u detyrua ta largojë sa më shpejt Hazreti Zejneben dhe pjesëtarët e tjerë të karvanit të Qerbelasë nga qendra e pushtetit të tij. Ai dha urdhër që ta kthenin Hazreti Zejneben dhe robërit e karvanit të Qerbelasë në Medine.

Karvani i robërve të Qerbelasë u dërgua në Damask duke u torturuar dhe duke u keqtrajtuar shumë. Mirëpo në kohën e kthimit ishin reduktuar këto tortura. Jezidi, nga frika e një revolucioni tjetër, kishte urdhëruar përgjegjësin e këtij misioni, që të sillej butë me pjesëtarët e Ehli Bejtit. Prandaj ai u mundua që karvanin e të mbeturve nga tragjedia e Ashures ta dërgojë në Medine. Ata, gjatë rrugëtimit nga Kufa për në Damask, ishin detyruar të



kalonin nëpër shumë qytete, ndërsa gjatë kthimit kaluan në një rrugë më të shkurtër, për të arritur më shpejt në Qerbela. Karvani, për t'u kthyer në atë vend të përgjakshëm, nxitonte me padurim dhe kalonte me lehtësinë më të madhe vështirësitë e rrugës. Në këtë mënyrë, karvani i Qerbelasë, më 20 Safar, ditën e dyzetë, pas martirizimit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), arriti në fushën e Qerbelasë, e cila në dialektin lokal quhej “Kerbu Bela”.

Pikëllimi për tragjedinë e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte një flakë që përvëlonte çdo zemër, e sidomos zemrën e Zejnebes. Ajo kishte përjetuar vuajtje të panumërta, ishte keqtrajtuar e



ishte rrahur, kishte përjetuar urinë e robërinë, mirëpo asnjëra prej këtyre vuajtjeve nuk e kishte munduar atë më tepër se sa ndarja nga vëllai.

Për çdo vit, besimtarët myslimanë, të cilët janë pasues dhe dashamirës të Ehli Bejtit të Resulallahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e përkujtojnë ngjarjen e Ashures dhe të dyzetat e Imam Hysenit (të arbeinit). Miliona besimtarë mbledhen çdo vit dhe vajtojnë tragjedinë që i ndodhi dritës së syve të Vulës së Profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), njëlloj sikur kjo ngjarje të ketë ndodhur tani e jo para 14 shekujsh.



Allahu na bëftë prej të bindurve ndaj Tij, ndaj Profetit Muhamed dhe ndaj Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe na bashkoftë me ta në Xhenet!

Nga Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) janë transmetuar shumë thënie, shumë prej të cilave janë edhe nga Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*). Prej tyre kemi zgjedhur të sjellim njëzet thënie.



Thënia 1

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ne, Ehli Bejti i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), jemi mjeti i lidhjes së Zotit me krijesat e Tij; ne jemi të zgjedhurit e pastër dhe të shenjtë të Zotit; ne do të jemi provë dhe udhërrëfyes; ne jemi trashëgimtarë të Profetëve të Allahut”.

قَالَتُ (عليها السلام): نَحْنُ وَسَيْلُهُ فِي خَلْقِهِ، وَنَحْنُ خَاصَّتُهُ وَمَحَلُّ قُدْسِهِ، وَنَحْنُ حُجَّتُهُ فِي غَيْبِهِ، وَنَحْنُ وَرَثَةُ أَنْبِيَائِهِ.

ما اهل بيت پیامبر، وسیله ارتباط خداوند با خلق او هستیم، ما برگزیدگان پاک و مقدس پروردگار می باشیم، ما حجت و راهنما خواهیم بود؛ و ما وارثان پیامبران الهی هستیم.



Thënia 2

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nëse veproni atë që kemi urdhëruar ne, Ehli Bejti dhe përmbaheni nga ajo që e kemi ndaluar, atëherë jeni ndjekësit tanë. Nëse veproni ndryshe, nuk jeni prej nesh”.

قَالَتْ (عليها السلام): إِنْ كُنْتُ تَعْمَلُ بِمَا أَمَرْنَاكَ وَتَنْتَهِي عَمَّا رَجَزْنَاكَ عَنْهُ، فَأَنْتَ مِنْ شِيعَتِنَا، وَإِلَّا فَلَا.

فرمود: اگر آنچه را که ما - اهل بیت عصمت و طهارت - دستور داده ایم عمل کنی و از آنچه نهی کرده ایم خودداری نمایی، تو از شیعیان ما هستی وگرنه خیر.



Thënia 3

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush i kryen adhurimet e tij dhe punon sinqerisht për Allahun, Ai do t’i japë atij prej mirësive dhe bekimeve më të mira”.

قَالَ (عليها السلام): مَنْ اضْعَدَ إِلَى اللَّهِ خَالِصَ عِبَادَتِهِ، أَهْبَطَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ لَهُ أَفْضَلَ مَصْلَحَتِهِ.

فرمود: هرکس عبادات و کارهای خود را خالصانه برای خدا انجام دهد، خداوند بهترین مصلحت‌ها و برکات خود را برای او تقدیر می‌نماید



Thënia 4

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kini parasysh se, kushdo që vdes me dashurinë ndaj familjes së Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen ë tij!*), është prej dëshmorëve”.¹⁵

«لا من مات على حب آل محمد مات شهيدا»

آگاه باشید هر کسی که بر دوستی آل محمد بمیرد، شهید است.

اثبات الهداة، ج ۲

¹⁵ “Ithbatul Hudati bi en Nususi uel Mu'xhizati”, vëll. 2.



Thënia 5

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Buzëqeshja dhe lumturia para besimtarit është shkak i hyrjes në Xhenet. Rezultati i buzëqeshjes para armiqve dhe kundërshtarëve do të jetë siguri nga ndëshkimi”.¹⁶

الْبُشْرَى فِي وَجْهِ الْمُؤْمِنِ يُوجِبُ لِصَاحِبِهِ الْجَنَّةَ، وَ الْبُشْرَى فِي وَجْهِ الْمُعَاوِدِ يَتَى صَاحِبِهِ
عَذَابُ النَّارِ.

تبسم و شادمانی در برابر مومن موجب دخول در بهشت خواهد گشت، و نتیجه تبسم در مقابل دشمنان و مخالفان سبب ایمنی از عذاب خواهد بود.

بحار الأنوار: ج ۴۳، ص ۵۴، ح ۴۸

¹⁶ “Biharul Enuar”, vëll. 43, f. 54, Thënia 48.



Thënia 6

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ata që vranë djalën e vajzës së Profetit të tyre, nuk do të shpëtohen dhe nuk do të jenë kurrë të lumtur”.¹⁷

خَابَتْ أُمُّهُ قَتَلَتْ إِيَّانَ بِنْتِ نَبِيِّهَا.

رستگار و سعادتمند نخواهند شد آن گروهی که فرزندان پیامبر خود را به قتل رسانند.
(مدینه المعاجز، ج ۳، ص ۴۳۰)

¹⁷ “Medinetu Me'axhizil Eimeti El Ithnej Ashr”, vëll. 3, f. 430.



Thënia 7

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen ë tij!*) dhe Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) janë prindërit e këtij populli. Nëse i ndjekin ata, do të shpëtojnë nga devijimet e kësaj bote dhe dënimi i përjetshëm në Ahiret. Ata do të përfitojnë nga bekimet e ndryshme dhe të bollshme të Xhenetit”.¹⁸

¹⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 23, f. 259, Thënia 8.

أَبُو هَذِهِ الْأُمِّ مُحَمَّدٌ وَ عَلَى، يُثْبِتَانِ أَوْدَهُمْ، وَ يُنْقِذَانِ مِنَ الْعَذَابِ الدَّائِمِ إِنْ أَطَاعُوهُمَا، وَ يُبِحَانِهِمُ التَّعِيمَ الدَّائِمَ إِنْ وَاقَفُوهُمَا.

حضرت محمد (ص) و علی (ع)، والدین این امت هستند، چنانچه از آن دو پیروی کنند آن‌ها را از انحرافات دنیوی و عذاب همیشگی آخرت نجات می‌دهند؛ و از نعمت‌های متنوع و وافر بهشتی بهره‌مندشان می‌سازند.

(بحار الأنوار، ج ۲۳، ص ۲۵۹، ح ۸)



Thënia 8

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Madhëruar e ka bërë besimin dhe bindjen për t’u pastruar nga politeizmi dhe për të shpëtuar nga zullumi dhe mjerimi. Namazin e ka bërë për t’u pastruar nga mendjemadhësia dhe për t’iu nënshtruar Atij. Zekatin e ka bërë për t’u pastruar, për të zgjeruar shpirtin dhe për të shtuar furnizimin. Agjërimin e ka bërë për të qenë të qëndrueshëm në sinqeritet dhe vullnet. Haxhin e ka bërë detyrë për forcimin e bazës së Sheriatit dhe ndërtimin e fesë islame”.

جَعَلَ اللَّهُ الْإِيمَانَ تَطْهِيراً لَكُمْ مِنَ الشِّرْكِ، وَ الصَّلَاةَ تَنْزِيهاً لَكُمْ مِنَ الْكِبَرِ، وَ الزَّكَاةَ تَزْكِيَةً
لِلنَّفْسِ، وَ نِإَاءً فِي الرِّزْقِ، وَ الصِّيَامَ تَثْبِيْتاً لِلْأَخْلَاصِ، وَ الْحَجَّ تَشْيِيداً لِلدِّينِ

خداوند سبحان، ایمان و اعتقاد را برای طهارت از شرک و نجات از گمراهی‌ها و شقاوت‌ها
قرار داد و نماز را برای خضوع و فروتنی و پاکی از هر نوع تکبر، مقرر نمود و زکات (و
خمس) را برای تزکیه نفس و توسعه روزی تعیین نمود و روزه را برای استقامت و اخلاص
در اراده، لازم دانست و حج را برای استحکام اساس شریعت و بناء دین اسلام واجب
نمود.



Thënia 9

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E vërteta dhe realiteti i gjithë lumturisë dhe shpëtimit do të jetë në miqësinë e Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) jo vetëm gjatë jetës së tij, por edhe pas vdekjes së tij”.

إِنَّ السَّعِيدَ كُلَّ السَّعِيدِ، حَقُّ السَّعِيدِ مَنْ أَحَبَّ عَلِيًّا فِي حَيَاتِهِ وَ بَعْدَ مَوْتِهِ.
ههنا حقيقت و واقعيّت تمام سعادت ها و رستگاری ها در دوستی علی (عليه السلام)
در زمان حیات و پس از رحلتش خواهد بود.



Thënia 10

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “O Allah, për hir të prindërve dhe të afërmve që ke zgjedhur, dhe për të qarat e fëmijëve të mi, pas vdekjes dhe ndarjes sime prej tyre, të kërkoj t’u falësh gjynahet ndjekësve dhe pasuesve tanë”.

إِلَهِى وَ سَيِّدِى، اسئَلُكَ بِالَّذِينَ اضْطَلَقْتَهُمْ، وَ بِبَكَاءِ وَلَدَىِّ فِى مُفَارَقَتِى أَنْ تُغْفِرَ لِعَصَاوِ شِيعَتِى، وَ شِيعَةِ ذُرِّيَّتِى.

فرمود: خداوندا، به حق اولیاء و مقربانی که آن ها را برگزیده ای، و به گریه فرزندانم پس از مرگ و جدائی من با ایشان، از تو می خواهم گناه خطاکاران شیعیان و پیروان ما را ببخشی.



Thënia 11

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Shi’itët (ndjekësit), pasuesit, dashamirët dhe ata që janë armiq të armiqve tanë (Ehli Bejtit), si dhe ata që na binden me zemrat dhe gjuhën e tyre, do të jenë njerëzit më të mirë në Xhenet”.

شيعتنا من خيارِ اهلِ الجنةِ وَكُلُّ مُجْتَبَا وَمَوَالِ أَوْلِيَانَا وَمُعَادَى اَعْدَائِنَا وَ الْمُسْلِمُ بِقَلْبِهِ وَ
لِسَانِهِ لَنَا.

فرمود: شیعیان و پیروان ما، و همچنین دوستداران اولیاء ما و آنان که دشمن دشمنان ما باشند، نیز آن هائی که با قلب و زبان تسلیم ما هستند بهترین افراد بهشتیان خواهند بود.

Thënia 12

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar nga Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kush i dërgon selam babait tim, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ose mua, për tri ditë rresht, Xheneti bëhet obligim për të”. Atë e pyetën: “Vetëm kur jeni në jetë (gjallë) apo edhe pas vdekjes suaj?” Ajo tha: “Qoftë sa jemi në jetë, qoftë pas vdekjes sonë”.

مَنْ سَلَّمَ عَلَيْهِ أَوْ عَلَى ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ أَوْجَبَ اللَّهُ لَهُ الْجَنَّةَ، قُلْتُ لَهَا: فِي حَيَاتِهِ وَحَيَاتِكَ؟ قَالَتْ:
نَعَمْ وَبَعْدَ مَوْتِنَا.

Herke br پدرم - رسول خدا - و بر من به مدت سه روز سلام کند خداوند بهشت را
برای او واجب می گرداند. راوی گوید: عرضه داشتم: آیا در زمان حیات و زنده بودن؟
فرمود: چه در زمان حیات ما باشد؛ و یا پس از مرگ.



Thënia 13

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar nga Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ajo që bëri Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me varrimin e të Dërguarit të Allahut, ishte detyra e tij hyjnore, ndërsa për atë që bënë të tjerët, Zoti do t’u kërkojë llogari dhe do t’i ndëshkojë”.

مَا صَنَعَ أَبُو الْحَسَنِ إِلَّا مَا كَانَ يُبْنِي لَهُ، وَ لَقَدْ صَنَعُوا مَا اللَّهُ حَسِبُهُمْ وَ طَالِبُهُمْ.
 آنچه را امام علی (علیه السلام) - نسبت به دفن رسول خدا و جریان بیعت - انجام داد،
 وظیفه الهی او بوده است، و آنچه را دیگران انجام دادند خداوند آن ها را محاسبه و
 مجازات می نماید.



Thënia 14

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar nga Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*): “Gjëja më e mirë për të ruajtur karakterin e një gruaje, është të mos shohë burrat e huaj dhe ata të mos e shohin atë”.

خَيْرٌ لِلنِّسَاءِ أَنْ لَا يَرَيْنَ الرِّجَالَ وَلَا يَرَاهُنَّ الرِّجَالَ.

بهترین چیز برای حفظ شخصیت زن آن است که مردی را نبیند و نیز مورد مشاهده مردان قرار نگیرد.



Thënia 15

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Jini gjithmonë në shërbim të nënës dhe në këmbët e saj, sepse Xheneti është nën këmbët e nënave. Rezultati do të jenë bekimet në Xhenet”.

الْزَّمْ رِجْلَهَا، فَإِنَّ الْجَنَّةَ تَحْتَ أَقْدَامِهَا، وَالْزَّمْ رِجْلَهَا فَمِمَّ الْجَنَّةُ .

همیشه در خدمت مادر و پای بند او باش، چون بهشت زیر پای مادران است؛ و

نتیجه آن نعمت های بهشتی خواهد بود.



Thënia 16

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Njeriu që nuk i lan duart, pasi ka ngrënë, nëse mërzitet, nuk duhet të fajësojë askënd përveç vetes”.

لَا يُلَوِّمُ امْرَأَةً إِلَّا نَفْسَهُ، يَبِيتُ وَفِي يَدَيْهِ رُغْمٌ.

Kësi që béd az خوردن غذا، دست های خود را نشوید دست هایش آلوده باشد، -

چنانچه ناراحتی برایش وجود آید - کسی جز خودش را سرزنش نکند.



Thënia 17

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar nga Hazreti Fatimja (*Paqja qoftë mbi të!*): “O Aba Hasan (O Ali)! Mua më vjen turp nga Zoti im, që të kërkoj diçka dhe ti nuk mund ta sigurosh”.

يا ابا الحسن، إني لاسئحى من إلهي أن أكلف نفسي ما لا تقدر عليّ.

من از خدای خود شرم دارم که از تو چیزی را در خواست نمایم و تو توان تهیه آنرا نداشته باشی.

Thënia 18

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) i është drejtuar popullit të Kufes: “A po habiteni që qielli pikoi gjak? Dënimi i Ahiretit është shumë më i rëndë dhe poshtërues se sa ky dhe në atë Ditë askush nuk do t’ju vijë në ndihmë”.¹⁹

أَفَعَجِبْتُمْ أَنْ تُنْطَرِ السَّمَاءُ دَمًا وَلِعَذَابُ الْآخِرَةِ أَكْزَىٰ وَهُمْ لَا يُنْصَرُونَ-

آیا از اینکه آسمان خون باریده تعجب می کنید؟ در حالی که عذاب آخرت در مقایسه با این امر، بسیار شدیدتر و خوار کننده تر است و در آن روز کسی به یاری شما نخواهد آمد.

¹⁹ Fjalim, drejtuar popullit të Kufes, “Biharul Enuar”, Al Lame Mexhlesi.



Thënia 19

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) i është drejtuar popullit të Kufes: “Nëse Profeti ju pyet, çfarë ishte kjo gjë që bëtë, edhe pse ishit kombi im i fundit dhe ishit më të nderuar se popujt e tjerë, si do t’i përgjigjeni? Çfarë keni bërë me familjen time, me fëmijët e me të dashurit e mi?! Një grup e keni robëruar, kurse grupin tjetër e keni lyer me gjak. Ky nuk ishte shpërblimi im, edhe pse unë isha mirëbërësi juaj, që të persekutoni kështu të afërmit e mi?! Kam frikë se i njëjti dënim që shkatërroi njerëzit e Iremi, do të bjerë edhe mbi ju”.²⁰

²⁰ Fjalim, drejtuar popullit të Kufes, “Biharul Enuar”, Al Lame Mexhlesi.

مَاذَا تَقُولُونَ إِذْ قَالَ النَّبِيُّ لَكُمْ مَاذَا صَنَعْتُمْ وَأَنْتُمْ آخِرُ الْأُمَمِ بِأَهْلِ بَيْتِي وَأَوْلَادِي وَكَرَمَتِي مِنْهُمْ
أَسَارَى وَمِنْهُمْ ضَرْجُوا بِدَمٍ مَا كَانَ ذَاكَ جَزَائِي إِذْ نَصَحْتُ لَكُمْ أَنْ تَخْلُقُونِي بِسُوءِ فِي ذَوِي رَحْمِي
إِنِّي لَأُخْشَى عَلَيْكُمْ أَنْ يَحُلَّ بِكُمْ مِثْلُ الْعَذَابِ الَّذِي أُودِيَ عَلَى لَارِمٍ ثُمَّ وَلَّتْ عَنْهُمْ -

اگر پیامبر از شما پرسد، این چه کاری بود که کردید با آنکه شما امت [پیامبر] آخر
الزمان بودید [و بر دیگر امت‌ها شرافت داشتید]، چه پاسخ خواهید داد؟ شما چه کردید
با اهل بیت و فرزندان و عزیزان من؟! جمعی را به اسارت بردید و گروهی را به خون
آغشته کردید. این پاداش من نبود - با آنکه من خیرخواه شما بودم - اینکه در حق
خویشاوندانم این‌گونه به من جفا کنید. من می‌ترسم همان عذابی که قوم «لارم» را به
نابودی کشاند، بر شما نیز فرود آید.



Thënia 20

Hazreti Zejnebja (*Paqja qoftë mbi të!*) i është drejtuar popullit të Kufes, pas martirizimit të Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*): “Mjerë ju o njerëz të Kufes! A e dini se çfarë lloj mëlçie i keni shkëputur të Dërguarit të Zotit? Çfarë grash e vajzash të dëlira e dinjitoze, nga familja e tij, keni tërhequr zvarrë në rrugë e tregje?! Çfarë gjaku keni derdhur në tokë?! E çfarë nderi i keni thyer atij?!²¹

²¹ Fjalim, drejtuar popullit të Kufes, “Biharul Enuar”, Al Lame Mexhlesi.

أَتَذَرُونَ وَإِلَّكُمْ أَيْ كَيْدٍ لِمُحَمَّدٍ ص فَرَّقْتُمْ وَإِنِّي عَنْهُ نَكَحْتُكُمْ وَإِنِّي كَرِهْتُ لَهُ أَنْ تَزْنَئُمْ وَإِنِّي خَزَمْتُ لَهُ هَتَكْتُكُمْ وَإِنِّي دَمَّ لَهُ
سَفَكْتُكُمْ

وای بر شمای مردم کوفه! آیا می دانید چه جگری از رسول خدا دریده‌اید؟ چه زنان و دختران با عفت و وقاری را از خاندان او به کوچه و بازار کشانده‌اید؟! چه خونی از آن حضرت بر زمین ریخته‌اید؟! و چه حرمتی از او شکسته‌اید؟!



Të durosh si Zejnebja, e bija e Imam Aliut

ZIJARETI I PËRMBLEDHUR I ZONJËS SË MADHE ZEJNEB (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

**Me emrin e Allahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!**

O Allah! Bekoje Muhamedin dhe
familjen e Muhamedit!

Paqja qoftë mbi ty, oj vajza e sulltanit
të profetëve!



Paqja qoftë mbi ty, oj vajza e poseduesit të burimit dhe flamurit!

Paqja qoftë mbi ty, oj bija e Fatime Zahrasë!

Paqja qoftë mbi ty, oj bija e Hatixhesë së madhe!

Paqja qoftë mbi ty, oj vajza e zotnisë së pasardhësve, Prijësi i besimtarëve!

Paqja qoftë mbi ty, oj vajza e të dashurit të Allahut!

Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qoshin mbi ty, o nëna e fatkeqësive, oj vajza e Aliut!



Paqja qoftë mbi ty, oj e virtytëshme
dhe e arsyeshme!

Paqja qoftë mbi ty, oj vepruese e
përkryer!

Paqja qoftë mbi ty, oj madhështore e
hijshme!

Paqja qoftë mbi ty, oj e devotshmja e
pastër!

Paqja qoftë mbi ty, oj e privuara e
pikëlluar!

Paqja qoftë mbi ty, oj e qeta e
kënaqur!



Paqja qoftë mbi ty, oj pasardhëse e të
pamëkatëshmit!

Paqja qoftë mbi ty, oj durimtare ndaj
fatkeqësive të Husejnit të privuar!

Paqja qoftë mbi ty, oj e largëta nga
horizontet!

Paqja qoftë mbi ty, oj robinë nëpër
qytete!

Paqja qoftë mbi atë, për virtytet e së
cilës dëshmojnë dy rëndesat!

Paqja qoftë mbi ty, oj çoroditëse në
qëndrimin tënd për të vrarët dhe që thirre
gjyshin tënd të Dërguarin e Allahut me
këtë thirrje: Ty të bekoj Sunduesi i qiellit!



Ky është Husejni me çallmë e rroba të hequra, me gjymtyrë të prera dhe këto janë vajzat e tua robina!

Paqja qoftë mbi shpirtin dhe trupin tënd të pastër!

Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi ty o zonja ime dhe e bija e zonjës time!

Dëshmoj se ti e fale namazin, e dhe zekatin, urdhërove për të mirë, ndalove nga e keqja, iu binde Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe durove vështirësitë në prani të Allahut derisa të erdhi vdekja.

Zoti e mallkoftë atë që të mohon ty!
Allahu e mallkoftë atë që të bëri padrejtësi



ty! Allahu e mallkoftë atë që nuk e njeh të drejtën tënde! Allahu i mallkoftë armiqtë e familjes së Muhamedit nga xhindët dhe njerëzit, nga i pari e deri te i fundit dhe ua shumëfishoftë dënimin e dhembshëm!

Erdha te ti, oj Zonja ime dhe bija e Zonjës time, për të të vizituar..., duke ditur të drejtën tënde, prandaj bëhu ndërmjetësuese te Allahu për faljen e mëkateve të mia, për plotësimin e nevojave të mia, për përmbushjen e kërkesës sime dhe për largimin e halleve të mia!

Sigurisht, ti, babai yt dhe paraardhësit e tu të pastër keni pozitë të



madhe dhe ndërmjetësim të
pranueshëm.

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut
qofshin mbi ty dhe mbi baballarët e tu të
pastër e të pastruar dhe mbi engjëjt që
qëndrojnë në këtë vend të shenjtë e të
bekuar!

Bismil-lahirr Rrahmanirr
Rrahijm

*All-llahumme sal'li ala Muhammedin ue
ala alii Muhammedin*

Es selamu alejki ja binte sulltanil enbijai

*Es selamu alejki ja binte sahibel haudhi
ue eliuai*



Es selamu alejki ja binte Fatimete Zahrai

*Es selamu alejki ja binte Khadixhetel
kubra*

*Es selamu alejki ja binte sej-jidel eusijai
ue ruknel eulijai emijrel mu'minijne*

Es selamu alejki ja binte uelij-jil'lahi

*Es selamu alejki ja um-mel mesaibi ja
Zejneb bintu Ali ue rahmetullahi ue
berekatuhu*

*Es selamu alejki ej-jetuhel fadhiletur-
rrashidetu*

*Es selamu alejki ej-jetuhel amiletul
kamiletu*



Të durosh si Zejnebja, e bija e Imam Aliut

*Es selamu alejki ej-jetuhel xhelijletul
xhemijletu*

*Es selamu alejki ej-jetuhet tekij-jetu en
nekij-jetu*

*Es selamu alejki ej-jetuhel medhlumetul
mak-huratu*

*Es selamu alejki ej-jetuhet radhij-jetul
mardhijetu*

Es selamu alejki ja talibetel ma'sumi!

*Es selamu alejki ja mumtehinete fi
teham-mulil mesaibi bil Husejnil madhlumi*

*Es selamu alejki ej-jetuhel bei'detul anil
afaki*



*Es selamu alejki ej-jetuhel esijretu fil
biladi*

*Es selamu ala men shehide bi fadliha eth-
thekelanu*

*Es selamu alejki ej-jetuhel mutehaj-jiretu
fij ukufiki fil katla ue nadejti xhed-deki
resulall-llahi bi hadha en nidai: sal'li
alejke melijku es semai hadha Husejnu bi araai
meslubul emameti ue er rridhai mukat-taul
a'dai' ue benatike sebaja*

*Es selamu ala ruhuki et taj-jibetu ue el
xhesedukit taahir*

*Es selamu alejki ja meulati ue ibnete
meulaje ue sej-jidetij ue ibnete sej-jidetij ue
rahmetull-llahi ue berekatuhu*



*Esh'hedu en-neki kad ekamtis salate ue
atejtiz zekate ue emerte bil ma'rufi ue nehejte
anil munkeri ue eta'tell-llahe ue rresulehu ue
saberti alel edhaij fi xhenbul'lahi hat-ta etaki
el jekijnu*

*Fe leanall-llahu men xhehadeki ue
leanall-llahu men dhalameki ue leanall-llahu
men lem ja'rif hak-kaki ue leanall-llahu a`dae
ale Muhammedin minel xhin-ni uel insi minel
euelijne uel akherijne ue dha-afe alejhim
adhabel elijmi*

*Etejtuki ja meulati ibnete meulati
kasiden uafiden arifen bi hak-kiki fe kunij
shefij'an ilall-llahi fij gufrani dhunubi ue
kadhaj hauaixhi ue a'tai su'li ue keshfe
dhur'rrij ue en-ne leki ue li ebijki ue*



*exhdadikit- tahirijne xhahen adhijmen ue
shefaeten makbuleten*

*Es selamu alejki ue ala abaikit tahirijnal
mutahirijne ue alal melaiketil mukijmijne fi
hadha haremesh sherijfil mubareki ue
rametull-llahi ue berekatuhu.*

زيارة السيدة زينب الكبرى سلام الله عليها

السلام عليك يا بنت سلطان الانبياء، السلام عليك يا بنت
صاحب الخوض واللواء، السلام عليك يا بنت فاطمة الزهراء،
السلام عليك يا بنت خديجة الكبرى، السلام عليك يا بنت سيد
الاروصياء وركن الاولياء أمير المؤمنين، السلام عليك يا بنت ولي
الله، السلام عليك يا ام المصائب يا زينب بنت علي ورحمة الله
وبركاته، السلام عليك أيتها الفاضلة الرشيدة، السلام عليك أيتها



العاملة الكاملة، السلام عليك أيتها الجليلة الجميلة، السلام عليك أيتها النقية النقية، السلام عليك أيتها المظلومة المقهورة، السلام عليك أيتها الرضية المرضية، السلام عليك يا تالية المعصوم، السلام عليك يا ممتحنة في تحمل المصائب بالحسين المظلوم، السلام عليك أيتها البعيدة عن الآفاق، السلام عليك أيتها الاسيرة في البلدان، السلام على من شهد بفضلها الثقلان، السلام عليك أيتها المتحيرة في وقوفك في القتلى وناديت جدك رسول الله (ص) بهذا النداء: صلى عليك ملك السماء هذا حسين بالعراء مسلوب العمامة والرداء مقطوع الاعضاء وبناتك سبايا، السلام على روحك الطيبة وجسدك الطاهر، السلام عليك يا مولاتي وابنة مولاي وسيدتي وابنة سيدتي ورحمة الله وبركاته، أشهد أنك قد أقيمت الصلاة وآتيت الزكاة وأمرت بالمعروف ونهيت عن المنكر وأطعت الله ورسوله وصبرت على الاذي في جنب الله حتى أتاك اليقين، فلعن الله من جحدك ولعن الله من ظلمك ولعن الله من لم يعرف حقك ولعن

الله أعداء آل محمد من الجن والانس من الاولين والآخرين
وضاعف عليهم العذاب الاليم. أتيتك يا مولاتي وابنة مولاي قاصدا
وافدا عارفا بحقك فكوني شفيعا إلى الله في غفران ذنوبي، وقضاء
حوائجي، واعطاء سؤلي وكشف ضري، وأن لك ولايتك وأجدادك
الطاهرين جاها عظيما وشفاعة مقبولة، السلام عليك وعلى آبائك
الطاهرين المطهرين وعلى الملائكة المقيمين في هذا الحرم الشريف
المبارك ورحمة الله وبركاته.



اسم الكتاب: لتصبر مثل زينب بنت علي عليها السلام

ترجمة: صبريه فزا

التصحيح الادبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الغلاف والإخراج النهائي: صبريه فزا

الناشر: جمعية نسيم

تيرانا: 2024